

FTESË PËR OFERTË

Emri: Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
Adresa: Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë
E-mail: infoacfdalbania@gmail.com
Afati i dorëzimit të ofertës: **10 Maj 2024**

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes po zbaton projektin “Forumi Tematik Rinor – një mjet për të fuqizuar të rinjtë në bashkinë Kavajë” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të përmirësojë ambjentin në shkollën 9-vjeçare ‘Sadi Tatani’ në fshatin Rrakull, Njësia Administrative Synej, Bashkia Kavajë.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **10/05/2024**, në adresën e e-mailit: infoacfdalbania@gmail.com ose në adresën postare: Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH
1.	Stola (6 copë) dhe kosha për konsum individual (6 copë) për ambjentin e jashtëm të shkollës	

Specifikime të përgjithshme teknike:

Produktet stola dhe kosha për konsum individual janë specifikuar si më poshtë:

Stola material hekuri, sasia 6 copë, përmasa 1.20 cm - 1.50 cm, material çelik i cinguar, i lyer me bojë me pjekje;

Kosha material hekuri, sasia 6 copë, diametri 40cm, lartësi 50-65 cm, me mekanizëm me përkulje për shkarkimin e mbeturinave, bazament çelik;

Produktete ofruara duhet të jenë cilësore dhe t'i përshtaten specifikimeve të përkruara më lartë.

Ofrimi i këtyre produkteve kërkohet brenda muajit Maj 2024.. Datat specifike do të përcaktohen në kontratën e lidhur me subjektin fitues

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe liçensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Kavajë dhe/ose Tiranë;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës infoacfdalbania@gmail.com brenda datës **10/05/2024** ose në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë.

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 4) PAGESA e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL (LEKE) dhe TVSH-ja të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) **Licensën për ushtrimin e aktivitetit (NIPT);**
- 2) **Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.**
- 3) **Numrin e llogarisë bankare.**
- 4) **Foto të produkteve (stoli dhe koshi)**

Operatori që ofron produktet me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.